

Kolegji shkarkon ish-prokuroren e Tiranës Donika Prelën

Ish-drejtuesja e Krimeve të Rënda, Donika Prela shkarkohet nga detyra dhe vendimi ka marrë formë të prerë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Procesi për ish-drejtuesen e Krimeve të Rënda mori një kohë relativisht të gjatë, duke shënuar mbarimin me seancën e këtij fund shtatori.

Seancat para shkallës së dytë të “vettingut” nuk ishin të njëtrajtshme.

Rihapja e hetimeve për Donika Prelën u bë me kërkesë të Komisionerit Publik, i cili kishte konstatuar disa pasaktësi në deklarin e të ardhurave të Donika Prelës.

Në një prej seancave Prela kërkoi edhe përjashtimin e dy gjyqtareve Natasha Mulaj e Ina Rama, por me vendim unanimit KPA vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë.

Donika Prela ishte një nga emrat që solli reagim edhe në qarqet politike për shkak të hetimit të disa dosjeve të forta që sollën jehonë në aktualitetin e vendit. Donika Prela u konfirmua në detyrë në shkurt të vitit të kaluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, dhe u deshën plot 7 muaj që shkalla përfundimtare e “Vettingut” për gjyqtarët dhe prokurorët të japë vendimin final.

Para marrjes së vendimit Donika Prela ishte caktuar si prokurore pranë Gjykatës së Tiranës.